

ANILA KANANAJ

**ARRITJE DHE PROBLEME NË KLASIFIKIMIN E PËRBËRËSVE
SINTAKSORË TË FJALISË: SINTAKSA E AT JUSTIN RROTËS
VS. SINTAKSA E AKADEMISË**

1. Hyrje

Klasifikimi i përbërësve të fjalisë është një ndër problemet që ende nuk është kapërcyer në sintaksën shqipe. Në varësi të qasjes gjuhësore, trajtimi njërit apo tjetrit grup autorësh paraqet përparësi apo mungesa. Në përpjekje për t'u thelluar më shumë këtë çështje, objekt i kësaj trajtëse do të jetë hulumtimi i kriterëve të klasifikimit të gjymtyrëve të fjalisë në dy sintaksa me peshë në gjuhësinë shqipe: në atë të At Justin Rrotës (2005 - ribotim i 1942) dhe në Sintaksën e Akademisë (1997). Arsyet e përzgjedhjes së këtyre dy veprave është se edhe Sintaksa e Rrotës, edhe Sintaksa e Akademisë, megjithëse u përkasin dy drejtimeve të ndryshme gjuhësore, përkatësisht drejtimit gjuhësor nën ndikimin e gramatikës së Port-Ruajalit dhe atij strukturalisht, përbëjnë pika kulminante në gramatologjinë shqipe dhe janë tekste të miratuara nga Ministria e Arsimit për t'u përdorur nëpër shkollat e vendit. Këto dy vepra do të shihen në përfaqje me njëra-tjetrën nën dritën e arritjeve të deritanishme në shkencën e sintaksës. Ndër të tjera, do të vlerësojmë rreptësinë shkencore, metodologjinë dhe kriteret shkencore të përzgjedhura dhe të zbatuara në secilën prej tyre.

2. Disa tipare të përgjithshme të dy Sintaksave

Në konceptimin e Rrotës, sintaksa: (a) është pjesë e gramatikës dhe studion (b) funksionin ("përdorimin"/ "përkimin" – Rrota), (c) përshtatjen ("pëlqimin" – Rrota), dhe (d) lidhjen e pjesëve të ligjëratës në fjali. Sipas Sintaksës së Akademisë, sintaksa: (a) është pjesë e gramatikës dhe studion (b) mënyrën e bashkimit të fjalëve në njësi sintaksore, dhe (c) raportet që krijohen, si dhe (d) rregullat e bashkimit të tyre. Në të dy veprat sintaksa konceptohet si pjesë e gramatikës dhe në qendër të kësaj disipline vihen lidhjet që krijohen midis fjalëve në fjali dhe funksioni që luajnë në fjali njësitë e krijuara nëpërmjet këtyre lidhjeve. Përshtatja trajtohet si kategori

sintaksore nga Rrota. Gjithashtu, në qendër të lidhjeve sintaksore që krijohen në fjalë, Rrota vë klasat e fjalëve dhe jo thjesht fjalët. Këto dy tipare e dallojnë këtë autor nga vepra tjetër me të cilën po e krahasojmë. Përshtatja dhe klasat e fjalëve (*pjesët e ligjëratës*) trajtohen si kategori sintaksore në gramatikën gjenerative, tipar që e gjejmë në Sintaksën e Rrotës dhe që i jep karakter modern veprës së tij.

Fjalja është njësia maksimale që studion sintaksa dhe kjo pranohet njësoj në të dy veprat. Mënyra e konceptimit të fjalisë ka ndryshime. Sintaksa e Rrotës është hartuar nën ndikimin e drejtimit logjik të Port-Ruajalit, ku duke qenë se gjuha shikohet sipas qasjes logjike¹, edhe fjalja shihet ashtu siç e shikon logjika, d.m.th. si njësi themelore e mendimit: “Pra mënyra ma e zakonshme me diftue m shka mendojm, është f j a l i j a . Fjalija pra, është një mendim i diftue m me fjalë.” (Rrota 2005). Ky lloj konceptimi i fjalisë sigurisht që ka të meta, por po të kemi parasysh se ndikimi i logjicizmit të Port-Ruajalit ka vazhduar paralelisht edhe në vendet fqinje (p.sh., Itali, Greqi, Rumani, etj.), nuk mund të themi se vepra e autorit është e “vonuar”. Përkundrazi, ajo është ecën krah për krah me arritjet e kohës. Sintaksat e Sheperit (1927), Xhuvanit (1933) dhe Cipos (1952) ecin në të njëjtën hulli.

Sintaksa e Akademisë është shkruar nën ndikimin e strukturalizmin evropian, pra ka gjurmë të *Kursit të gjuhësisë së përgjithshme* (1915) të Sosyrit dhe të *Elemente të sintaksës strukturore* (1959) të Tenierit, ku fjalja shihet si njësi e ligjërit (parole) dhe jo e gjuhës (langue). Analiza e strukturës së brendshme të fjalisë (konceptimi i kryefjalës, kallëzuesit dhe lidhjes e varësisë që krijohen midis elementeve të fjalisë) ishte ajo që dalloi qartë strukturalizmin nga periudha e gramatikës së Port-Ruajalit. Strukturalizmi kërkoi që fjalja të përkufizohej dhe të analizohet vetëm në qasje gramatikore, prandaj në Sintaksën e Akademisë fjalja është trajtuar si njësi sintaksore themelore e ligjërit, e shprehur me një a më shumë fjalë të lidhura gramatikisht sipas ligjeve të gjuhës shqipe, të shqiptuara me intonacion mbarimi dhe që shpreh një kumtim të caktuar (Çeliku et al. 1997, 110–12). Fjalja mund të ketë gjymtyrë kryesore (kryefjalë, kallëzues), kryegjymtyrë, gjymtyrë të dyta dhe e pagjymtyrëzueshme kur nuk zbërthehet dot gramatikisht as në kryefjalë, as në kallëzues apo në

¹ Kupto: sipas disiplinës së logjikës.

Arritje dhe probleme në klasifikimin e përbërësve sintaksorë të fjalisë...

ndonjë gjymtyrë tjetër. Fjalja ka zakonisht një bërthamë kallëzuesore². Ndërsa kur ka dy më shumë bërthama të tilla, është quajtur periudhë³ (Çeliku et al. 1997, 423).

Sa i takon termit *gjymtyrë* që përbën një njësi pune të analizës sintaksore në të dy veprat, ai rezulton i përdorur së pari nga Rrota dhe më vonë në Sintaksën e Akademisë. Në të dy veprat gjymtyra përdoret me të njëjtin kuptim. Gjymtyra i referohet një a më shumë fjalëve në fjali që kryejnë një funksion sintaksor në fjalinë e thjeshtë, p.sh., funksionin e kryefjalës, kundrinorit, kallëzuesit, rrethanorit ose përcaktorit. Pra gjymtyra përshkruan mjetet sintaksore me të cilat realizohen kryefjala, kallëzuesi, kundrinori, rrethanori ose përcaktori në fjali. Në gjuhësinë perëndimore termat përkatës për gjymtyrën e fjalisë janë *përbërës sintaksor*. Termi *përbërës* po përdoret gjithnjë e më shumë dhe mund të pohohet se ka zënë vend në gramatologjinë shqipe. Natyrshëm ky zëvendësim termash të shpie në pyetjen nëse është i vjetëruar termi *gjymtyrë fjalie*. Në aspektin kohor, termi *gjymtyrë* mund të identifikohet me një periudhë të caktuar të zhvillimit të sintaksës në gramatologjinë shqipe. Në aspektin përmbajtësor, përdorimi i tij paraqet probleme. Problemi kryesor është mungesa e përkapjes së paralelizmit fjali me nënrenditje – togfjalësh kur të dyja këto njësi luajnë role të ngjashme brenda periudhës. Sipas teorisë së gjymtyrës, kjo (gjymtyra) gjendet vetëm në fjalinë e thjeshtë. Në periudhë (në fjalinë e përbërë) nuk ka më gjymtyrë por fjali me nënrenditje. Kështu p.sh., rolin e kundrinorit të drejtë mund ta luajë një fjalë e vetme, një grup fjalësh ose edhe një fjali me nënrenditje. Gjymtyrë do të quheshin vetëm dy të parat edhe pse të tira luajnë në njëjtin rol të kundrinorit të drejtë.

3. Kryegjymtyrët

Në të dy Sintaksat, gjymtyrët e fjalisë ndahen në gjymtyrë kryesore, ndryshe kryegjymtyrë dhe në gjymtyrë të dyta. Në gjymtyrët kryesore përfshihen kryefjala dhe kallëzuesi. Rrota përdor paralelisht termat subjekt/kryefjalën dhe predikat/kallxojë/kalxues.

² Thuhet zakonisht, pasi në tipin e fjalive të paplota pa kallëzues dhe fjalitë e pagjymtyrëzueshme mungon një kallëzues i realizuar fonetiki (Çeliku et al. 1997, 402–10).

³ Termi *periudhë* është përdorur nga Xhuvani (1933), Sheperi (1927b), Domi (1954), Buchholz & Fidler (1987), Memushaj (Memushaj 2003, 2008), Topalli (2011), etj. Si variant i këtij termi gjendet edhe *periodë* (Cipo 1952).

3.1. Kryefjala

Dihet se kryefjala realizohet me një emër në rasën emërore ose me një grup fjalësh, përkatësisht togfjalësh⁴ që ka në bosht një emër në këtë rasë.

Në Sintaksën e Akademisë, kryefjala dhe kallëzuesi nuk mund të kuptohen pa njëri-tjetrin (Çeliku et al. 1997, 165). Mosrealizimi fonetik i njërit prej tyre çon në mospranimin e tjetrit, pra pa kryefjalë nuk ka kallëzues dhe e kundërta, ka vetëm një gjymtyrë kryesore. Ky parim rrjedh nga parimi përkatës i materializmit dialektik. Në Sintaksën e Rrotës ky parim i materializmit dialektik nuk gjendet, mosprania e njëres gjymtyrë kryesore nuk mohon gjymtyrën tjetër. Kështu, kryefjala mund të jetë edhe e nënkuptuar (mospërsëritja e përemrave vetorë – kryefjalë, dhe përsëri fjalia ka kallëzues dhe pranohet që ka dy gjymtyrë (Rrota 2005). Në këtë drejtim, Sintaksa e Rrotës afron me gramatikën gjenerative e cila pranon kryefjalë të parealizuar fonetiki, përkatësisht *pro* dhe *PRO*.

Rrota mbështetet në kritere semantiko-formale për të përkufizuar kryefjalën. Sipas tij, kryefjala:

- Shpreh frymorin a sendin për të cilin flitet.
- I përgjigjet pyetjes *kush* për frymorë dhe *shka* për jofrymorë.
- Është gjithmonë në rasën emërore.
- Shprehet me një emër, përemër, ose çdo fjalë që luan rolin e emrit.
- Mund të jetë edhe e nënkuptuar (Rrota 2005: 8).

Në Sintaksën e Akademisë përdoren kritere formale për të përkufizuar kryefjalën. Sipas kësaj vepre, kryefjala:

- Është gjymtyrë kryesore.
- Krijon lidhje kallëzuese me kallëzuesin.
- Shprehet me emër, përemër, me numëror ose me çdo pjesë të emëruar të ligjëratës, por edhe me togfjalësh.
- Rasa emërore është rasa tipike e saj (Çeliku et al. 1997, 167).

Siç shihet, kriteri semantik është i pranishëm te Sintaksa e Rrotës, por jo në Sintaksën e Akademisë. Kriteri i pyetjes zbatohet në të dy Sintaksat, megjithëse në Sintaksën e Rrotës jepet drejtpërdrejt në

⁴ *Togfjalëshi* është term i Sintaksës së Akademisë që i referohet një njësie pune sintaksore të ngjashme me atë që sot quhet *sintagmë*, megjithatë duhet pasur parasysh se ka dallime të rëndësishme midis togfjalëshit dhe sintagmës.

Arritje dhe probleme në klasifikimin e përbërësve sintaksorë të fjalisë...

përkufizimin kryesor. Në Sintaksën e Akademisë, si njësi minimale e analizës së fjalisë përdoret gjymtyra, pra edhe në lidhje me kryefjalën. Kjo është një përparësi e kësaj sintakse. Siç u vu në dukje edhe pak më lart, në Sintaksën e Rrotës pranohet kryefjala e nënkuptuar, ndërsa në Sintaksën e Akademisë jo. Ky kriter përbën dallim të madh.

3.2. Kallëzuesi

Në Sintaksën e Rrotës edhe *kallxoja/predikati* shihet sipas kritereve semantiko-formale. Konkretisht, *kallzoja*:

- Tregon atë që thuhet për kryefjalën.
- Realizohet me folje të shtjelluar (“në mënyrën skajore”).
- Realizohet me folje që kërkojnë pas vetes edhe një fjalë ndihmëse, si: a) emër në emërore, gjinore a kallëzore me ose pa parafjalë, ose edhe në lidhje me fjalëzën *si*; b) mbiemër, pjesore; c) përemër a numëror në rolin e mbiemrit; ç) folje në mënyrën paskajore, dhe d) ndajfolje (2005, 11).

Në Sintaksën e Akademisë kallëzuesi:

- Është gjymtyrë kryesore që hyn në lidhje kallëzuesore me kryefjalën.
- Dallohet kallëzuesi foljor vetëm me folje të shtjelluara, me përjashtim të rasteve si: “Ata dolën pa dalë dielli.”, ku folja e pashtjelluar lidhet me një kryefjalë të vetën.
- Kallëzuesi emëror vjen pas foljes *jam*.
- Kallëzuesi shprehet edhe me pjesë të pandryshueshme të ligjëratës: *Qentë ham-ham*.
- *Tërr telefoni*. (f. 173)
- Kallëzuesi foljor mund të jetë i thjeshtë ose i përbërë (Çeliku et al. 1997, 173–74).

Lidhja kryefjalë – kallëzues, sipas Rrotës, shihet në çdo strukturë, p.sh. edhe në fjali me folje njëvetore (pavetore). Po ashtu, kryefjala është gjithmonë në rasën emërore. Ajo hyn në lidhje me një kallëzues të shprehur me folje të shtjelluar. Të ashtuquajturat kryefjalë në rrjedhore autori i sheh si kryefjalë logjike (jo gramatikore!), rezultat të një cilësi të nënkuptuar. Ndërkaq, lidhja kryefjalë – kallëzues në Sintaksën e Akademisë mbështetet në parimin e materializmit dialektik: pa kallëzues nuk ka kryefjalë dhe pa kryefjalë nuk ka kallëzues (uniteti i kundërvënies binare: nuk ka formë pa përmbajtje dhe nuk ka përmbajtje pa formë). Nuk

pranohet formalizmi, pra as gjymtyrët e eliptuara. Pranohen kallëzues të shprehur me pjesë të pandryshueshme të ligjëratës, por jo me forma të pashtjelluara që nuk kanë kryefjalën e tyre:

Në këtë kohë tërr telefoni!

Zagarët ham ham!

Ne po se po.

(E njeh ti atë djalë?) – Po. – Ah! – tha Prela. (Çeliku et al. 1997, 173, 197)

Përveç kritereve formale e kuptimore, në Gramatikën e Akademisë ka edhe kritere ideologjike-politike në konceptimin e kryegjymtyrëve. Në këtë drejtim, mungesa e ideologjizimit dhe mbështetja vetëm në kritere shkencore i jep përparësi sintaksës së Rrotës. Gjithashtu, pozitive në Sintaksën e Rrotës është përfshirja e kriterit semantik në përkufizimin e kryegjymtyrëve, kriter i cili mungon në Sintaksën e Akademisë.

As Rrota, as Sintaksa e Akademisë nuk pranojnë që kallëzuesi të shprehet me folje të pashtjelluara. Ky koncept mund të kuptohet për kohën kur ka punuar Rrota, mund të quhet konservator për kohën kur është shkruar Sintaksa e Akademisë, por sot është i tejkaluar nga gjuhësia botërore.

Sidoqoftë, përkufizimi dhe konceptimi i kryefjalës dhe kallëzuesit nga Rrota ka përparësi në aspektin pedagogjik, pasi është më i kapshëm.

4. Gjymtyrët e dyta

Në gjymtyrët e dyta përfshihen përbërësit sintaksorë që varen nga gjymtyrët kryesore, siç janë kundrinorët, rrethorët dhe përcaktorët. Në këtë punim do të përqendrohemi vetëm te kundrinorët dhe rrethorët.

4.1. Kundrinori

Në përcaktimin e kundrinorit përdoren disa kritere, si p.sh., kriteri i varësisë, kriteri morfologjik (pjesa e ligjëratës nga e cila varet dhe me të cilën shprehet), kriteri i domosdoshmërisë, kriteri i pyetjes dhe transformës. Të gjitha këto kritere janë përdorur edhe në Sintaksën e Akademisë. Në këtë vepër kundrinori dallohet sipas rasës dhe sipas ndërtimit (me parafjalë). Emri në rasën kallëzore është gjithmonë kundrinor i drejtë, ndërsa emri në rasën dhanore quhet kundrinor i zhdrejtë pa parafjalë. Në bazë të kriterit të pyetjes, në kategorinë e kundrinorit me parafjalë janë përfshirë një sërë sintagmash parafjalore që në të vërtetë nuk janë të tilla

(Kananaj 2015).

Në Sintaksën e Rrotës *kundrina/objekti në kallxore/objekti në dishmore*⁵ përfshin kundrinën e drejtë dhe “dy kallxoret/dy dishmoret”, pra përcaktorin kallëzuesor të kundrinës. Kundrina në dhanore emërtohet kundrinë e zhdrejtë në Sintaksën e Akademisë. Ajo shënjon sendin mbi të cilin veprimi i foljes bie tërthorazi. *Kundrina në rrjedhore/objekti në hjekto* dallohet nga autori në bazë të kriterit të pyetjes dhe kriterit morfologjik (Rrota 2005, 37). P.sh.:

*Kush asht ngjallë së dekunit?
Shqiptarët lahen duersh para buket.
Thaj ndokend brijësh.*

Ky lloj kundrinori nuk përmendet si i tillë në Sintaksën e Akademisë, pasi përbën një tipar sintaksor dialektor, ndërsa Sintaksa e Akademisë përshkruan shqipen standarde.

Në *kundrinën parafjalore* folja ka të domosdoshëm një plotës parafjalor që të plotësojë kuptimin e saj. Ky është kriteri që jep Rrota për dallimin nga ndajfoljori, kriteri i cili realisht nuk është i mjaftueshëm.

Përfshirja e kundrinës në dhanore dhe e kundrinës me parafjalë nën termin *kundrinë e zhdrejtë* është kritikuar nga R. Memushaj (2007). Edhe pse në Sintaksën e Akademisë shtohet se kundrina mund të varet jo vetëm nga një folje e mbiemër, por edhe nga një emër foljor, kriteri i vërtetë që i bashkon këto pjesë ligjëratë është që funksionojnë si predikat.

Kundrina e drejtë dhe “dy kallxoret” shfaqin veçori të ndryshme strukturore, prandaj përfshirja e tyre në një kategori të vetme nuk është e përlligjur. Pranimi i kategorisë së përcaktorit kallëzuesor në Sintaksën e Akademisë është risi, por gjithsesi jo pa probleme.

Trajtimi i kundrinorit në këto dy Sintaksa në vija të përgjithshme mund të shërbejë për të krijuar një ide për gjendjen e studimeve shqipe mbi këtë kategori të rëndësishme. Megjithëse këtë kategori e trajtuam shumë shkurt, del e qartë nevoja për një studim të thelluar të saj në gjuhën shqipe.

4.2. Rrethanorët

Rrota u referohet si ndajfoljorë (advërbjar) plotësve që kryejnë funksion të ngjashëm me ndajfoljen në fjali. Ndajfoljorët autori i ndan në

⁵ Ky është termi që përdor autori, prandaj sa herë që përdorim termin *kundrinë* jemi duke iu referuar mendimit të Rrotës.

ndajfoljorë vendi, kohe, mënyre dhe shkaku (2005, 47–52). Në konceptimin e ndajfoljorëve kriteri i varësisë gërshetohet me kriterin semantik: ndajfoljori plotëson kuptimin e foljes ose të mbiemrit, duke treguar vendin, kohën, mënyrën dhe shkakun. Te ky i fundit përfshihen dhe kuptimet e qëllimit, mjetit, kushtit, lejimit dhe të lëndës. Për sa i përket termit *ndajfoljor*, ai është përzgjedhur në bazë të kriterit morfo-sintaksor, pra nënkupton që shprehet me ndajfolje ose gjymtyrë që luajnë rolin e ndajfoljes. Për këtë arsye, ky term na duket më i goditur se termi *rrethanor* i Sintaksës së Akademisë, i cili ka baza semantike. Ndërkaq, Rrota përdor në të njëjtën kohë edhe termi *adëverbrar* të huazuar nga gramatikat latine.

Mbështetur në kriterin e pyetjes me parafjalë, një pjesë e konsiderueshme e përbërësve sintaksorë që te Sintaksa e Rrotës trajtohen si ndajfoljorë, në Sintaksën e Akademisë trajtohen si kundrina me parafjalë. Gjithashtu, në Sintaksën e Akademisë nuk bëhet dallimi i rrethanorit të sasisë nga fjalët a grupet e fjalëve që luajnë rolin e fjalëve të shkallës, p.sh.:

Ngjitëm një mur dy metra të lartë.

Sa iku ajo, hapi sytë dhe pa murin, që e kishte dy pëllëmbë më tej. (Çeliku et al. 1997, 280)

Përbërësit me të zeza janë rrethanorë sipas Sintaksës së Akademisë, qëndrim i kritikuar nga Kananaj (2015). Lidhur me këtë çështje, Rrota mban qëndrim tjetër pasi ai nuk e pranon kategorinë e ndajfoljorëve të sasisë.

4.3. Probleme të klasifikimit të gjymtyrëve të dyta

Në të dy Sintaksat del e qartë se autorët janë të vetëdijshme për problemet në përcaktimin e kufijve kategorialë të gjymtyrëve të dyta. Kriteri morfologjik i përdorur në klasifikimin e gjymtyrëve të dyta si nga Rrota, ashtu edhe në Sintaksën e Akademisë lë të hapur çështjen e kufijve kategorialë. Problemi i përbërësve me varësi të dyfishtë në fjali mbetet i pazgjidhur në të dyja veprat. Ndërkaq, zgjidhja e dhënë në Sintaksën e Akademisë për dallimin e rrethanorit nga kundrinori me parafjalë është më shumë pedagogjike sesa shkencore. Rrota në fakt, i trajton më saktë, pasi vë në punë kriterin e plotësisë kuptimore të foljes drejtuese për kundrinat, në dallim nga ndajfoljorët që janë “disi ma larg”. Kananaj (2015) është munduar ta zgjidhë këtë çështje duke i trajtuar këta përbërës si fjali të vogla (struktura predikative minimale). Autorja jep disa kriterë për

dallimin e rrethorëve nga kundrinorët me parafjalë: a) kriteri i fakultativitetit, b) kriteri i zëvendësimit, c) kriteri tematik (rolet tematike), dhe d) varësia nga predikati (në vend të kriterit morfologjik). Sidoqoftë, kjo çështje ende nuk mund të quhet e shteruar.

5. Përfundime

Të dy veprat e marra në analizë përbëjnë pika kulmore, me prurje të rëndësishme në gramatologjinë shqipe. Sintaksa e At Justin Rrotës ka disa tipare të rrymave moderne sot, siç është p.sh., vendi më i gjerë që zë aspekti semantik, pranimi i përshtatjes dhe i klasave të fjalëve si kategori sintaksore, pranimi i formalizmit në sintaksë (kategoritë e zbrazëta si elipsa, kryefjala apo kallëzuesi i nënkuptuar etj.), por natyrshëm bart edhe tiparet e kohës në të cilën është shkruar (konceptimi i fjalisë dhe i gjymtyrëve të saj). Në Sintaksën e Akademisë vlerësohet më shumë aspekti strukturor. Përshtatja është studiuar, por jo si kategori sintaksore. Gjymtyrë fjalie të pashprehura fonetiki nuk pranohen. Këto reflektohen edhe në klasifikimin e gjymtyrëve të fjalisë. Kriteri ideologjik i materializmit dialektik në lidhje me gjymtyrët kryesore të fjalisë nuk përbën përparësi për Sintaksën e Akademisë. Njohja e një njësie pune për analizën e elementeve sintaksore të fjalisë, si dhe analiza e detajuar e marrëdhënieve që krijohen midis njësive të fjalisë përbën një tipar të vlerësueshëm të Sintaksës së Akademisë.

Në përfundim, pohojmë me bindje se një sintaksë e re e shqipes do të konsultohet me të dyja këto vepra themelore të gramatologjisë shqipe.

BIBLIOGRAFI

- Buchholz, Oda, and Wilfried Fiedler. 1987. *Albanische Grammatik*. Verlag Enzyklopädie. Leipzig: Verlag.
- Çeliku, Mehmet, Mahir Domi, Spiro Floqi, Seit Mansaku, Remzi Përnaska, Stefan Prifti, and Menella Totoni. 1997. *Gramatika e gjuhës shqipe, II: Sintaksa*. Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.
- Cipo, Kostaq. 1952. *Sintaksa*. Tiranë: Instituti i Shkencave.
- Domi, Mahir. 1954. *Gramatika e Gjuhës Shqipe II. Sintaksa*. Tiranë: Ministria e Arsimit.
- Kananaj, Anila. 2015. *Rrethorë në gjuhën shqipe*. Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.
- Memushaj, Rami. 2003. *Gjuhësia gjenerative*. 1st ed. Tiranë: shblu.

- . 2007. 'Tri koncepte themelore të sintaksës moderne'. *Studime filologjike*, no. 3–4.
- . 2008. *Gjuhësia gjenerative*. 2nd ed. Tiranë: shblu.
- Rrota, At Justin. 1942. *Syntaksa e Gjuhës Shqipe, Për Klasën II, III, IV Të Shkollave Të Mesme*. Shkodër: Shpija botuese 'A. Gj. Fishta'.
- . 2005. *Sintaksi i shqipes*. III. Shkodër: Botime Françeskane.
- Saussure, Ferdinand de. 1915. *Course in General Linguistics*. Charles Bally and Albert Sechehaye. New York, Toronto, London: McGraw-Hill Book Company.
- Sheperi, Ilia Dilo. 1927. *Gramatika Dhe Sintaksa e Gjuhës Shqipe*. Vlorë.
- Tesnière, Lucien. 1959. *Éléments de syntaxe structurale*. Paris: Klincksieck.
- Topalli, Tefë. 2011. *Gramatikë e Gjuhës Shqipe: Sintaksa e Fjalisë*. Shkodër.
- Xhuvani, Aleksandër. 1933. *Njohnit e Para Të Sintaksës Shqipe*. Tiranë: Shtypshkronja 'Teknike'.